

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Avdi Dinaj kryetar kolegji, Nesrin Lushta dhe Emine Kaçiku anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve A. M., N. S., G. S. dhe V. Sh., për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale: përgatitja e veprave terroriste nga neni 144 par. 1 dhe par.2 lidhur me nenin 31, pjesëmarrja në grup terrorist nga nenin 143 par.2 të KPK-së lidhur me nenin 135 par. 4 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe blerja e paautorizuar e armëve nga nenin 372 par. 2 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe i pandehuri A. M. është akuzuar edhe për veprën penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.1 në lidhje me nenin 135 par.4 të KPK-së, kryerja e veprës terroriste e cila rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave nga nene 136 par.2 të KPK-së, në lidhje me nenin 135 par. 1 dhe 4 të KPK-së , prodhimi i materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPK-së, dhe posedimi i paautorizuar i materieve plasëse nga neni 374 par. 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A. M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.252/15 të datës 18.10.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1863/2016 të datës 26.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.12.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuara kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit A. M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.252/15 të datës 18.10.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1863/2016 të datës 26.10.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.252/15 të datës 18.10.2016, të pandehurit A. M. ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 23.10.2016 deri me 23.12.2016, ndërsa të pandehurve N. S., G. S. dhe V. Sh. ia ka vazhduar masën e paraqitjes në stacion policor në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 23.10.2016 deri me 23.12.2016, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale: përgatitja e veprave terroriste nga neni 144 par. 1 dhe par.2 lidhur me nenin 31, pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPK-së lidhur me nenin 135 par. 4 lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe blerja e paautorizuar e armëve nga neni 372 par. 2 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe i pandehuri A. M. është akuzuar edhe për veprën penale : mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.1 në lidhje me nenin 135 par.4 të KPK-së, kryerja e veprës terroriste e cila rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave nga neni 136 par.2 të KPK-së, në lidhje me nenin 135 par. 1 dhe 4 të KPK-së , prodhimi i materieve plasëse nga neni 372 par.1 të KPK-së, dhe posedimi i paautorizuar i materieve plasëse nga neni 374 par. 1 të KPK-së. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, dhe 1.2.3 të KPPK.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Kundër këtij aktvendimi ankesë kanë paraqitur mbrojtësit të pandehurve, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.1863/2016 të datës 26.10.2016, i ka refuzuar si të pabazuar ankesat dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A. M. av. L. P., për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës penale nga neni 193 lidhur me nenin 185 par.2 dhe 187 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës

të prish aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë dhe të pandehurit t'i caktohet ndonjë masë tjetër më e butë.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi kryesisht thekson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë e po ashtu edhe ai i gjykatës së shkallës së dytë është i pabazuar dhe i paarsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë të drejtë, se arsyetimi në lidhje me shkaqet mbi të cilat vazhdohet paraburgimi mbetet i njëjtë në tërësi pra vetëm bëhet përshkrimi i dispozitivit dhe i pretendimeve të akuzës, se me këto vendime paragjykohet jo vetëm gjendja faktike por edhe të pandehurit i shkelet e drejta që i njëjti të konsiderohet i pafajshëm deri në arritjen e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, se të pandehurit i dihet vendbanimi, se dokumentet e udhëtimit janë konfiskuar me kohë nga organet e rendit, se antarët e familjes nuk janë larguar jashtë shtetit prandaj nuk ekziston rreziku i ikjes sikur që nuk ekziston as rreziku për të kryer vepra tjera penale nga se i pandehuri nuk është recidivist, nuk ekziston intervali i shkurtër kohor me të cilin i pandehuri ka kryer shumë vepra penale apo karakteri i raporteve në mes të pandehurit dhe viktimës, si dhe përmend shumë rrethana tjera pa ekzistimin e të cilave nuk mund të vazhdohet paraburgimi. Mbrojtësi gjithashtu thekson se me vazhdimin e paraburgimit po rrezikohet seriozisht mbijetesa e bashkëshortes dhe fëmijës së të pandehurit të cilët jetojnë me 50€ në muaj nga asistenca sociale.

Opinionimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.66/16 të datës 16.12.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit A. M. të refuzohet si e pabazuara.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e çështjes kryesisht nga aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.94/2013 e datës 23.01.2015, provat e fituara nga masat e fshehta të hetimit, objektet e gjetura në vendbanimin e të pandehurit, intervista e të pandehurit e dhëna në polici më 06.11.2013, transkriptet e diskutimeve që janë zhvilluar ndërmjet të pandehurve, deklaratat e dëshmitarëve, procesverbali mbi mundësinë e hetuesisë së veçantë PPRKR.347/13 të datës 11.2.2014 të Gjykata Themelore në Prishtinë, si dhe provat tjera të mbledhura gjerr më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehurit është kryerës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se ndaj tij është ngritur aktakuza për veprat penale të cilat janë të natyrës së rëndë, dhe parashihen dënime mjaft të larta, gjithashtu i pandehuri A. M. shumë lehtë mund të lagohen nga Kosova nga fakti se i njëjti vazhdimisht ka udhëtuar dhe ka banuar jashtë vendit dhe i cili dyshohet se për një kohë të gjatë edhe ishte trajnuar në një kamp ushtarak dhe pastaj ishte vendosur në një fshat në Siri duke qëndruar dy muaj aty, andaj i njëjti mund të jet i paaritshëm për organet e ndjekjes dhe kështu do ta pamundësojë zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, fakti se vepra penale është në bashkëkryerje me një planifikim paraprak, ashtu që i pandehuri A. M. pas kthimit nga Siria në Kosovë, sipas shkresave të lëndës, i njëjti dyshohet se u bë anëtar i një grupi të cilët ndaj pikëpamje ekstreme fetare, dhe të cilët kishin blerë armë dhe ishin në posedim të eksplozive, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale së natyrës së njëjtë.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.328/2016 datë 19,12,2016.

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetar kolegjit,
Avdi Dinaj